

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Të më thërrasin "shërbyes" është më mirë sesa të më thonë "udhëheqës", sepse udhëheqja nuk është e rëndësishme. I rëndësishëm është shërbimi, sepse Islami na urdhëron për shërbim.

Imam Homeini (r.a)

Fjalë të vyera

Nga Imam Homeini (r.a)

Tiranë, qershor 2006

Titulli: **Fjalë të vyera**

E përktheu nga arabishtja: **Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jetmir Çela**

Kopertina: **T. Gorbani**

Përkujdesja grafike: **Sabrie Feza**

Radhitja kompjuterike: **Vullnet Merja**

Botoi: Shoqata **“Flladi”**

© Copyright: Shoqata **“Flladi”**

Tirazhi: **1000** kopje

Shtypur në shtypshkronjën **“Emal”**

Në vend të parathënies

Njeriu! Qënia më e përsosur e gjithësisë. Qënia e cila është quajtur zëvendësi i All-llahut në Tokë. Qënia, për të cilën Krijuesi ka vendosur në shërbim të tij çdo gjë. Qënia, të cilën All-llahu e ka dalluar nga qëniet e tjera nëpërmjet intelektit, mendjes. Pra, o njeri mëtoje veten tënde dhe vendos se si duhet të jesh. Mëto o njeri se Krijuesi të ka sjellë ligje e rregulla, të cilat të sigurojnë e të garantojnë përsosurinë, qytetërimin, lumturinë, qetësinë dhe ardhmërinë tënde. Mëto o njeri se Krijuesi yt ka sjellë të dërguar, të cilët i përzgjedhi nga



mesi yt, me qëllim që të sqarojë ato ligje e rregulla të Krijuesit tënd dhe të të udhëzojë ty në rrugën e drejtë e të shpëtimit.

Por, është për të ardhur keq, se ti o njeri nuk i bindesh plotësisht urdhërave të Krijuesit dhe nuk i zbaton detyrat e ngarkuara. Si pasojë e këtij indiferentizmi nga ana jote, sot shohim me qindra fatkeqësi e tragjedi në mesin e bashkësisë tënde. Atëherë, të drejtohem ti o njeri, si t'i shfarosim këto dukuri negative, që në të njëjtën kohë janë shkatërruese dhe vdekjeprurëse? Përgjigja është shumë e thjeshtë. Për këtë, në radhë të parë kthehu tek vetja jote, sepse brenda teje ndodhet “grykë” e cila do të të orientojë kah ajo që është më e përsosur dhe kjo grykë është ndërgjegja jote. E nëse nuk arrin të nxjerrësh konkluzionin e duhur për shkak të konfliktit intelekt-ego, atëherë mëto më thellë dhe drejtohu kah bashkësia jote, sepse në të do të gësh patjetër



përkrahës dhe udhëzues. Është detyrë e jotja o njeri, që bashkësia në të cilën ti jeton të jetë e pastër dhe e lumtur. Por kjo pastërti e kjo lumturi arrihet vetëm e vetëm duke filluar me ndryshimin e vetes tënde e më pas të punosh për ndryshimin e të tjerëve dhe të mos presësh që kjo ndreqje të të vijë vetvetiu apo gjëkund, sepse Krijuesi yt në Librin e Tij Fisnik, Kur'anin, thotë: ***“All-llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë vetet e tyre.”***

Pra, o njeri, është detyrë që të ndreqim vetet tona drejt asaj që është më e mira, sepse me anë të këtij veprimi arrijmë të fitojmë lumturinë individuale, më pas atë familjare dhe në fund atë shoqërore.

O njeri! Të gjithë jemi dëshmitarë se kjo dukuri neveritëse që gjendet në mesin e shoqërisë njerëzore e ka burimin tek vetë njeriu. Këtë e dëshmon edhe All-llahu në



Kur'an ku thotë: "Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit, etj.)... "

Nëse i hedhim një vështrim historisë njerëzore, do të vërejmë se misioni kryesor i profetëve ka qenë reformimi shoqëror.

Ky është Profeti Muhammed (s.a.v.s), i cili me durim e me ndihmën e All-llahut, arriti të bëjë një reformim të fuqishëm në shoqërinë arabe, duke i shfarosur ato dukuri të cilat janë në kundërshtim me *fitran* e (natyrshmërinë e lindur të) njerëzve. Historia na tregon se ky veprim asnjëherë nuk është ndalur, por ai ka vazhduar, vazhdon dhe do të vazhdojë deri në mbarimin e kësaj jete.

O njeri! Duhet që t'i hedhim një sy historisë së kaluar për të mësuar se si vepruan profetët, e më pas disa personalitete e udhëheqës, në kryerjen e reformimit të shoqërive, siç ishin Imam Husejni e më pas reformatori



bashkëkohor, Imam Homeini. Duhet të dimë se reformimi i një shoqërie bëhet me mjete e me metoda të ndryshme dhe më e mira metodë është “urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga të këqijat”.

Të nderuar lexues! Shoqata “Flladi” sjell në duart tuaja punimin e saj të dytë, librin me titull “Fjalë të vyera”, me anë të të cilit pasqyron një shembull ideal për të mos u kursyer në veprimin e punëve të mira. Ky libër botohet me rastin e përkujtimit të 17-vjetorit të ndërrimit jetë të reformatorit islamik, imam Homeinit. Ky libër përmban thënie dhe këshilla të imam Homeinit rreth temave të ndryshme. Në fund të këtij libri kemi botuar edhe mesazhin që imam Homeini i dërgoi Gorbaçovit, i përkthyer nga Nexhat Ibrahimimi.



Detaje nga jeta e Imam Homeinit

Ruhullah El-Homeini u lind në vitin 1902 në qytetin Homein, i cili gjendet ndërmjet Arakut dhe Kashamit. Pas disa muajsh i vdiq i ati Sejjid Mustafa El-Musaviu. Në të vërtetë atë e vranë disa feudalë, ngase ai i akuzoi për eksploatimet dhe padrejtësitë që i bënin popullit. Në moshën 16 vjeçare i vdiq edhe e ëma, kështu që ai qysh i ri mbeti jetim. Në moshën 25 vjeçare arriti shkallën më të lartë të arsimimit dhe i plotësoi të gjitha kushtet për të kryer detyrën e mual-limit dhe të muxhtehidit. Dy vjet më vonë, në moshën 27 vjeçare, ai u martua me vajzën e Ajatullah Mirza Muhammed Es-Sakif Et-Teheraniut. Më 5 qershor 1963, *regjimi i shabut* e burgosi



imamin. Burgosja e tij shkaktoi revoltë në popull, i cili doli në demonstrata dhe kërkoi lirim e Imam Homeinit. Shahu e urdhëroi policinë që të gjuajë mbi turmën e demonstruesve me armë zjarri dhe si pasojë, ranë dëshmorë 15000 vetë. Imam Homeini (All-llahu qoftë i kënaqur me të) qëndroi në burg deri më 6 prill 1964, kur shahu dhe qeveria e tij, të frikësuar nga pakënaqësitë mbarëpopullore e liruan nga burgu. Në nëntor të vitit 1964, Imamin e dëbuan në Turqi, sepse ai me një fjalim të tijin e kishte kërcënuar shahun dhe qeverinë iraniane të asaj kohe, e cila vepronte nën influencën amerikane. Gjatë qëndrimit të tij në Turqi, ai shkruajti veprën “Tahrirul vesileh” (vepër fik’hu, në dy vëllime). Pas dy vjetësh, Turqia e prishi miqësinë me të dhe e dëboi, kështu që ai u strehua në Irak. Përderisa ai ndodhej në Nexhef, SAVAK-u (policia sekrete e shahut) ia vrau djalin, Sejjid Mustafanë. Kur dëgjoi



për vrasjen e djalit, i qetë tha: “Inna lil-lahi ve inna ilejhi raxhi‘unë” (Ne jemi të Allahut dhe te Ai do të kthehemi.)

Revista *Itila'* e datës 09.01.1968, botoi një artikull në të cilin ofendohej Imam Homeini dhe disa ulema tjerë. Ai, në shenjë proteste, organizoi demonstrata të mëdha, me në krye ulematë e Fakultetit të Shkencave në Kom. Demonstrata u mbajtën edhe nëpër qytete të mëdha të Iranit, kështu që ndërhyjnë organet shtetërore dhe disa besimtarë ranë dëshmorë.

Më 3 shtator 1968, me miliona njerëz dolën të demostrojnë rrugëve të qyteteve dhe bashkërisht falnin namaz duke i dhënë përkrahje politikës së Imam Homeinit. Shahu shpalli gjendje të jashtëzakonshme. Kurse Sadam Huseini, me urdhër të superfuqive, ia ndaloi Homeinit qëndrimin në Irak. Të njëjtën gjë e bëri edhe Kuvajti. Në vitin 1970, u detyrua të udhëtojë në Paris, në Francë. Më 1 shkurt 1979 Imami u kthye sërish në Teheran,




ku iu bë pritje madhështore. Thuhet se e kanë pritur rreth 5 milionë besimtarë prej aeroportit e deri te varrezat **Beheshti Zehra**. Më 8 shkurt 1979, Imam Homeini e emëroi qeverinë e përkohshme, ndërsa më 11 shkurt, në mënyrë zyrtare u shpall fitorja e Revolucionit Islamik në Iran dhe përfundimisht u rrëzua qeveria e tmerrshme e shahut. Më 9 Prill 1979 Imam Homeini i ndërpreu të gjitha marrëdhëniet me Amerikën, duke e shallur këtë ditë, ditë feste. Më 18 shtator, Republikën Islamike e sulmoi Iraku, kështu që Imami u detyrua që të mobilizojë popullin vullnetarisht dhe të kërkojë prej tyre që t'i respektojnë urdhërat e Komandës së Lartë Ushtarake dhe në të njëjtën kohë të angazhohen maksimalisht kundër regjimit të Sadam Huseinit. Më 18 korrik 1985, Imam Homeini ra dakord që të ndërpritet lufta me Irakun, sipas rezolutës Nr. 598 të OKB-së.



Kah fundi i vitit 1989, Imami (paqja qoftë mbi të) i dërgoi letër Mihail Gorbaçovit dhe i bëri thirrje që të pranojë Islamin, me çka do t'u mundësonte besimtarëve të atjeshëm që t'i shprehnin dhe t'i manifestonin lirisht ndjenjat e tyre fetare. Në shkurt të vitit 1989, për shkak të hemoragjisë së brendshme që pati, Imamit iu bë ndërhyrje kirurgjikale, e më 4 qershor të po atij viti, ai ndërroi jetë në spital (rahmetullahi alejhi). Vdekja e tij pikëlloi zemrat e miliona muslimanëve. Më 6 qershor 1989, trupi i Imam Homeinit (mëshira e Allahut qoftë mbi të) u varros në prani të dhjetë milionë njerëzve, në varrezat **Beheshti Zehra**, në Teheran.





**Njohja e All-llahut
dhe adhurimi i Tij**

➤ **All-llahu është dritë**

Nuk ka dritë përveç All-llahut (xh.sh.) dhe çdo gjë tjetër është errësirë.

➤ **All-llahu, Krijuesi i gjithçkaje**

Të gjithë ne jemi prej All-llahut. E gjithë bota është krijesë e All-llahut dhe çdo gjë i përket Atij.



➤ **Qëllimi i të dërguarve**

Vërtet, qëllimet e gjithë të dërguarve (profetëve) përmbliidhen në një frazë të vetme që është: *Njohja e All-llahut.*

➤ **Qëllimi i shpalljes**

Vërtet, qëllimi kryesor i shpalljes është përcimi i njohjes së All-llahut (xh.sh.).

➤ **Detërat e pafund**

Hyni në detin e Njëshmërisë (së Krijuesit), në detin e profetësisë dhe në detin e Kur'anit Famëlartë dhe zhytuni në thellësitë e tyre.

➤ **Etika e adhurimit**

Prej etikës së adhurimit është që të mos njihni fuqi tjetër përveç fuqisë së All-llahut (xh.sh.) dhe të mos lavdëroni tjetër përveç të Vërtetit (xh.sh.) dhe të dashurit e Tij.



➤ **Shkaku i poshtërimit**

Nëse punët tuaja nuk janë të lidhura me All-llahun dhe nëse përçaheni, sigurisht që ju do të jeni të poshtëruar.

➤ **Frika ndaj All-llahut** (xh.sh.)



Unë po ju them: Mos iu frikësoni tjetërkujt përveç All-llahut (xh.sh.) dhe mos shpresoni te askush tjetër përveçse tek All-llahu.

➤ **Qëllimi i ftesës**

Është detyrë e jona që të ftojme të tjerët, me kusht që ftesa të mos jetë për vetet tona e as për dynjanë (për interes vetjak apo jetik), por t'i ftojme në rrugën e All-llahut.

➤ **All-llahu është i pranishëm**

All-llahu ekziston, prandaj mos u bëni të pavëmendshëm ndaj Tij, sepse Ai është prezent dhe çdo gjë është nën mbikqyrjen e Tij.

➤ **Mbikqyrja e All-llahut (xh.sh.)**

Për çdo punë që të bëni, duhet t'i frymëzoni zemrat tuaja se All-llahu ju mbikqyr.

➤ **Vlera e punës**

Në punë nuk është e rëndësishme forma e saj, por qëllimi i saj.

➤ **Vlerësimi i njerëzve**

Etaloni bazë në Islam është kënaqësia e All-llahut dhe jo kënaqësia e njerëzve. Ne i



vlerësojmë njerëzit në bazë të përljes (bindjes) së tyre ndaj All-llahut (xh.sh.).

➤Kujdes!

Kujdes, o njerëz! Kujdes, o shtet! Tregohuni të gjithë të kujdesshëm, sepse ju jeni në praninë e All-llahut dhe të gjithë do të jepni llogari nesër. Mos ecni mbi gjakun e dëshmorëve tuaj pa e çarë kokën!



➤Mos u përçani

E gjithë bota është në praninë e All-llahut (xh.sh.), prandaj mos bëni mëkate dhe mos u përçani për gjëra të kota e të paqëndrueshme. Punoni për All-llahun dhe dilni në rrugën e Tij.

➤ **Mbështetja tek All-llahu (xh.sh.)**

Mbështetuni në All-llah, sepse mbështetja në All-llahun (xh.sh.) është rrugëzgjdhja e të gjitha problemeve tuaja, me shpresën e All-llahut.

➤ **Shërbimi ndaj fesë së All-llahut (xh.sh.)**

Të gjithë ne jemi prej All-llahut, prandaj duhet që të jemi në rrugën e shërbimit të Tij (të fesë së Tij).



➤ **Begatitë e All-llahut (xh.sh.)**

Vërtet, All-llahu (xh.sh.) është Ai i Cili na ka dhuruar të gjitha të mirat, prandaj duhet që ne t'i shpenzojmë ato mirësi në rrugën e Tij (xh.sh.).



**Të dërguarit
e All-llahut**

➤ **Qëllimi i dërgimit të profetëve**

All-llahu i ka dërguar profetët për të shpëtuar moralin e njerëzve, vetet e tyre, shpirtërat e tyre dhe trupat e tyre prej errësirave. Jo vetëm kaq, por që t'i zhdukim errësirat dhe t'i zëvendësojnë ato me dritën.

➤ **Muhammedi (s.a.v.s.), profeti i begative**

Që nga fillimi i krijimit e deri në fund, bota nuk ka parë e as nuk do t'i shohë begatitë e ndonjë krijese tjetër, siç shijoi begatitë në kohën kur ndodhej profeti fisnik (Muhammedi s.a.v.s.).



➤ **Profeti nuk flet ngavetja e tij**

Profeti më i famshëm (Muhammedi a.s) është hija e All-llahut. Ai nuk ka sjellë asgjë nga vetja e tij, sepse çdo thënie e tij ka qenë shpallje e shpallur.

➤ **Profetët janë konsensualë**

Nëse do t'u jepej mundësia që të gjithë profetët të bashkoheshin në një kohë të vetme, ata nuk do të binin në kundërshtim kurrë.



➤ **Lëndimet e të dërguarve**

S'ka dyshim se të dërguarit lëndohen për shkak të mohuesve dhe dyftytrakëve (hipokritëve), po ashtu edhe me fundin të cilin ata zgjodhën.

➤ **Detyra e profetëve**

Të dërguarit janë njëlloj si mjekët. Ata u dërguan për të reformuar shoqëritë.

A decorative horizontal frame with intricate floral and geometric patterns on both ends. The frame is double-lined and contains the text "Feja islame" in a bold, black, serif font.

Feja islame

➤ **Qëllimi i Islamit**

Islami ka ardhur për edukimin e njeriut.

➤ **Programi i Islamit**

Islami ka zbritur për edukimin e njeriut dhe objekti më i rëndësishëm i programit islam është njeriu dhe edukimi shpirtëror i tij.

➤ **Reformimi**

Islami ka ardhur për reformimin e shoqërisë.

➤ **Ligjet e Islamit**

S'ka dyshim se Islami, përsa i përket anës së të drejtave, përmban rregulla integrimi të plota e gjithëpërfshirëse.



➤ **Ligjet islame, mbi mendimin njerëzor**

S'ka dyshim se ligjet e Islamit janë përmbledhëse dhe gjithëpërfshirëse deri në atë shkallë, saqë e bën lexuesin e tyre që të pohojë se ato ligje e tejkalojnë kufirin e mendimit njerëzor. Ato ligje nuk mund të jenë produkt i aftësive shkencore e mendore të njeriut.

➤ **Gjithëpërfshirja e Islamit**

Islami nuk ka ardhur për një popull të posaçëm. Ai nuk bën dallim mes turqve, persianëve dhe arabëve. Islami është fe për të gjithë dhe sistemi i tij nuk i jep përparësi racës, ngjyrës, fisit dhe gjuhës.



➤ **Islami nuk e njeh dallimin**

Në sistemin islam nuk ka dallim mes njerëzve.

➤ **Si të arrijmë tek burimi i kthjellët?**

Është detyrë e jona që t'i thyejmë muret e injorancës dhe të legjendave, me qëllim që të arrijmë në burimin e kthjellët të Islamit origjinal që solli Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij).



➤ **Islami, pëmbushës i nevojave**

Sikur popujt t'i hedhin një vështrim Islamit, ata do të gjejnë në të të gjitha ato për të cilat kanë nevojë.

➤ **Feja e Lirisë**

Islami është feja e lirisë dhe e pavarësisë.

➤ **Islami, sigures i nevojave**

Islami ka për qëllim që të realizojë përsosurinë e vërtetë dhe t'i sigurojë njerëzisë nevojat e tyre, qofshin këto politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

➤ **Çfarë përfshin mesazhi islam?**

Mesazhi islam nuk është i kufizuar me anën shpirtërore e as atë materiale, por ai i përfshin të dyja këto anë. Kjo do të thotë që Islami dhe Kur'ani kanë ardhur për të ndërtuar njeriun dhe për edukimin e tij në të gjitha aspektet.



➤ **Themeluesi i shtetit**

Vërtet, i Dërguari i All-llahut, Muhammedi (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) vendosi bazat e politikës në fe. Ai formoi shtetin.

➤ **Ligjepër çdo fazë të jetës**

S'ka dyshim se në Islam gjenden rregulla dhe programe për çdo fazë të jetës së njeriut, që nga lindja e deri në varr.



➤ **Qëllimet e ligjeve islame**

S'ka dyshim se ligjet e Islamit kanë qëllime të larta. Ato garantojnë lirinë, pavarësinë dhe lartësimin.



**Mbrojtja
e Islamit**

➤ **Adhurimi më i madh**

S'ka dyshim se mbrojtja e së vërtetës dhe mbrojtja e Islamit është prej adhurimeve më të mëdha.

➤ **Interesat e Islamit**

Mbrojtja e interesave të Islamit dhe e interesave të përgjithshme është më e rëndësishme sesa mbrojtja e interesave personale.



➤ **Detyra jonë**

Të gjithë ne e kemi për detyrë që të mbrojmë Islamin dhe jemi përgjegjës për të. Mbrojtja e Islamit në këto ditë që jetojmë, qëndron në mirëkuptimin mes nesh.

➤ **Udhëheqja dhe lartësimi**

Nëse do t'ia paraqitni botës Islamin në formë të rregullt dhe nëse e praktikoni ashtu siç duhet praktikuar, atëherë udhëheqja dhe lartësimi do të jenë pjesë e juaja.

➤ **Cili quhet "vend islam"?**

Një vend quhet "*vend islam*" nëse në të zbatohen parimet e Islamit.

➤ **Çfarë sjell praktikimi i Islamit?**

Nëse doni të shpëtoni prej prangave të të huajve dhe prej robërisë së tyre, atëherë kapuni me (praktikoni) Islamin.



➤ **Qëllimi i krijimit tonë**

Ne jemi krijuar me qëllim që të ringjallim traditën profetike, të ringjallim Kur'anin dhe na kërkohet që të zbatojmë detyrat tona të caktuara nga Islami.

➤ **Islami dhe Kur'ani**

Islami dhe Kur'ani janë ndihmëtari juaj.



➤ **Udhëheqësi i vendit**

Vërtet, qëllimi ynë është i përkufizuar në përpjekjet që ta bëjmë vendin tonë “*vend islam*”, Kur'ani të jetë udhëheqësi i tij dhe profeti Muhammed dhe evlijatë (të zgjedhurit) e tjerë të jenë drejtuesit e tij.

➤ **Premtimi dhe sakrifica**

O ju muslimanë praktikues! Vërtet, ju e zbatuat premtimin ndaj All-llahut dhe Islamit madhështor. Ju na mësuat se ç'është premtimi dhe ç'është sakrifica.

➤ **Zhdukja e padrejtësive**

Nëse ligjet e All-llahut do të zbatohen nga një popull, atëherë padrejtësitë do t'i zhduken atij populli.

➤ **Amaneti ynë**

Islami është amanet në duart tona dhe ne e kemi për detyrë që ta mbrojmë këtë amanet.





Kur'ani

➤ **Kur'ani dhe njohja e All-llahut** **(h.sh.)**

Po të mos ishte Kur'ani, porta e njohjes së All-llahut do të qëndronte e mbyllur përgjithmonë.

➤ **Kur'ani, udhëzuesi ynë**

S'ka dyshim se Kur'ani është ai që na udhëzon në qëllimet tona të larta, mirëpo ne jemi të pavetëdijshtëm për këtë.

➤ **Kur'ani, libër i begative**

Është detyrë e muslimanëve që Kur'anin ta kenë shoqëruesin e tyre, sepse ai është Fjala e All-llahut dhe libri i udhëzimit. Çdo mirësi që zotërojnë dhe do të zotërojnë muslimanët, janë prej begative të këtij Libri të Shenjtë.



➤ **Flamuri i Kur'anit**

Sa herë që praktikoni diçka nga Kur'ani, ju do të mbuloheni me hijen e flamurit të tij. Flamuri i Kur'anit ndryshon nga flamujt e tjerë. Dhe flamuri i Kur'anit është *zbatimi i tij*.

➤ **Kur'ani, mesazhi më i lartë**

Nuk ka mesazh më të lartë se Kur'ani.



➤ **Kur'ani dhe jeta**

Duhet që Kur'ani të jetë i pranishëm në të gjitha çështjet e jetës tonë.

➤ **Të drejtat e Kur'anit ndaj nesh**

S'ka dyshim se Kur'ani ka të drejta ndaj nesh dhe ndaj gjithë njerëzisë. Për këtë, ai e meriton sakrificën.

➤ **Problemi i muslimanëve**

S'ka dyshim se problemi më i madh i muslimanëve qëndron tek largimi i tyre nga Kur'ani dhe hyrja nën flamurin e të tjerëve.

➤ **Krenaria**

S'ka dyshim se çdo gjë që e bëjmë në rrugën e All-llahut dhe në rrugën e Kur'anit, ajo është krenari dhe jemi krenarë, sepse ajo është rruga e vërtetë.

➤ **Vendstrehimi ynë**

Kur'ani është vendstrehim për të gjithë ne.





**Ringjallja
dhe gjykimi**

➤ **Dita e Gjykimit, e
padyshtë**

Kini kujdes se para nesh ndodhet një ditë tjetër dhe mos dyshoni në të. Po, para nesh ndodhet një ditë në të cilën do të japim llogari për çdo gjë. Në atë ditë njeriu do të bëjë llogaritë e vetes së tij. Atë ditë do të dëshmojnë lapsat, duart, sytë.... Po, s'ka dyshim se ajo ditë do të vijë.

➤ **Regjistri i punëve**

S'ka dyshim se regjistri i punëve tona ndodhet tek All-llahu. Në këtë regjistër është shënuar çdo gjë.



➤ **Çdo gjë është e regjistruar**

S'ka dyshim se çdo fjalë, apo edhe çdo gërmë që ne shqiptojmë, do të na shfaqen atë ditë dhe do të hyjnë në peshoren e punëve tona.

➤ **Edukimi i vetvetes**

Edukojini vetet tuaja dhe pastrojini ato, sepse kjo jetë është kalimtare dhe do të largohemi prej saj të gjithë, unë së bashku me ju.





**Pärpjekjet
reformuese**

➤ **Kushti i ndreqjes së vendit**

Nëse nuk kemi ndrequr vetet tona, nuk mund ta ndreqim vendin tonë.

➤ **Kur të fillojmë me ndreqjen e të tjerëve?**

Duhet që njeriu të fillojë me ndreqjen e vetes së tij dhe të përpiqet që ta bëjë besimin, moralin dhe punët e tij në përputhje me rregullat e Islamit. Nëse arrin të ndreqë veten e tij, atëherë t'i drejtohet ndreqjes së të tjerëve.



➤ **Pavarësia e vendit**

Nëse dëshironi që vendi i juaj të jetë i pavarur dhe të tjerët të mos e gjejnë mundësinë që të ndërhyjnë në çështjet e tij të brendshme, duhet që të filloni të ndreqni vetet tuaja.

➤ **Detyrë e përgjithshme**

Ndreqini vetet tuaja, që të ndreqet vendi juaj.

➤ **Cila është ndreqja e vërtetë?**

Ajo që është më e domosdoshme për ne, është që të ndreqim vetet tona dhe të mos bindemi vetëm me ndreqjen e jashtme, por të përpiqemi që të fillojmë të ndreqim zemrat dhe mendjet tona. Atëherë të bindemi që dita e nesërme do të jetë më e mirë se dita e sotme.

➤ **Aritja e qëllimit**

Nëse i ndreqim vetet tona, atëherë qëllimi që ne kemi do ta përfshijë mbarë botën në mënyrë të menjëhershme.



➤ **Revolta e brendshme**

Duhet që ne të shpërthejmë “revolucion” në brenditë tona dhe të bëjmë revoltë me vetet tona. Nësa vetet tona vazhdojnë të jenë nën sundimin e djallit, duhet patjetër që të revoltohemi me vetveten.

➤ **Pasojat e mosedukimit**

Nëse nuk e edukojmë veten, atëherë dituria do të jetë mbulesë errësire mbi të.



➤ **Rezultatet e këshillave**

Unë frikësohem që fundi i disave të jetë Xhenneti (parajsa) për shkakun tonë dhe për shkak të këshillave tona, e më pas ne të përfundojmë në Xhehennem (ferr), për shkak se ne nuk i kemi edukuar vetet tona.

➤ **Festa e vërtetë**

S'ka dyshim se festë e vërtetë është ajo ditë në të cilën njeriu arrin të fitojë kënaqësinë e All-llahut.

➤ **Ndreqja e çështjeve**

Nëse besimi do të zërë vend në zemër, të gjitha çështjet do të ndreqen.

➤ **Roli i besimit**

Besimi është baza e të gjitha mirësive (qofshin materiale apo shpirtërore) dhe e përparimit për çdo vend.

➤ **Devotshmëria**

Devotshmëria është themeli i krenarisë.



➤ **Zgjidhja e problemeve**

Nëse besimi në All-llah dhe veprimi për hir të Tij do të jenë në çdo aktivitet shoqëror, politik, ekonomik dhe në çështjet e tjera të jetës së njeriut, atëherë shumica e problemeve do të zgjidhen, qofshin edhe nga ato më të vështirat.

➤ **Sëmundjet e rrezikshme**

S'ka dyshim se sëmundjet psikike janë më të rrezikshme se sëmundjet trupore.



➤ **Pasojat e vetëpëlqimit**

Vetëpëlqimi është burimi i të gjitha shkatërrimeve të cilat janë shfaqur në mesin e njerëzisë, që nga krijimi i saj e deri në ditët e sotme. Por ai është edhe burimi i të gjitha fatkeqësive që do ta godasin atë deri në fundin e kësaj jete.

➤ **Pengesa për të sakrifikuar**

Përderisa ju jeni robër të veteve tuaja dhe të egos tuaj, kurrë nuk do të keni mundësinë që të sakrifikoni në rrugën e All-llahut dhe të mbronni dispozitat e Tij.

➤ **Pasojat e dashurisë së kësaj jete**

S'ka dyshim se të gjitha shkatërrimet shpirtërore, morale e shoqërore e kanë burimin tek dashuria e kësaj dynjaje (bote) dhe nga pavëmendshmëria ndaj All-llahut (xh.sh.)



➤ **Paqëndrueshmëria e postit**

S'ka dyshim se çdo post që arrin një njeri, qoftë nga ana shpirtërore apo materiale, ai do të zhduket në një ditë që nuk është e ditur (se kur).

➤ **Kush i frikësohet vdekjes?**

S'ka dyshim se frika ndaj vdekjes gjendet tek ai që e quan këtë jetë të përhershme dhe është i pavëmendshëm ndaj vendqëndrimit të përhershëm dhe ndaj fqinjësisë së mëshirës së përhershme.

➤ **Detyra e përgjithshme**

Urdhërimi në të mira (për të kryer vepra të mira) dhe ndalimi nga të këqijat është detyrë e të gjithë bijve të popullit.



➤ **Detyra e dijetarëve**

Nëse njerëzit i sundon ndonjë udhëheqës i padrejtë, është detyrë e dijetarëve dhe e intelektualëve të popullit që ta kundërshtojnë atë dhe të luajnë rolin e tyre në ndalimin nga e keqja.

➤ **Kundërshtimi i padrejtësisë**

Motoja jonë është që *të mos i bëjmë padrejtësi askujt dhe të mos e pranojmë padrejtësinë.*

➤ **Bashkimi kundër padrejtësive**

Duhet që muslimanët të jenë të bashkuar kundër të padrejtëve.

➤ **Esenca e thirrjes**

Vërtet, esenca e thirrjes në Islam është thirrja për unitet dhe mospërçarje.

➤ **Besimtarët janë vëllezër**

Kur'ani Famëlartë dëshmon se të gjithë besimtarët në mbarë botën janë vëllezër.



➤ **Burimi i mirësive**

Vëllazëria islame është burimi i të gjitha mirësive.

➤ **Në Islam nuk ka dallime**

Në Islam nuk ka sunnit apo shi'it, kurd apo persian, sepse të gjithë janë vëllezër.

➤ **Vëllazërimi mes nesh**

Është detyrë e jona - sunnitë dhe shi'itë - që të vëllazërohemi me qëllim që t'u presim rrugën atyre që përpiqen të na grabisin.

➤ **Përçarja dhe bashkimi**

Përçarja është prej djallit, ndërsa bashkimi dhe mospërçarja është prej të Gjithëmëshirshmit.



➤ **Përçarja është vetëvrasje**

Përçarja dhe konflikti në këto ditë konsiderohen vetëvrasje.

➤ **Gjuha e shejtanit**

Prej asaj gjuhe nga e cila dalin fjalë për përçarje, ajo gjuhë është e shejtanit.

➤ **Rrezikshmëria më e madhe**

S'ka dyshim se konflikti mes *ehlis-sunneh uel xhema'ab* dhe mes *shi'abve*, përhapja e shpifjeve për të nxitur përçarjen dhe armiqësinë mes vëllezërve muslimanë, kjo është më e rrezikshme dhe më shkatërruese sesa përplasjet etnike.



➤ **Pasojat e heqjes së lirisë**

S'ka dyshim se poshtërimi i njeriut dhe rënia e tij vijnë si pasojë e heqjes së lirisë, duke e bërë atë që të dorëzohet para të tjerëve.

➤ **Varfëria dhe Liria**

Ne e pranojmë të jetojmë jetë të varfër, me kusht që të jemi të lirë e të pavarur.



➤ **Njohja e njeriut**

Njeriu është esenca e të gjitha krijesave të gjithësisë.

➤ **Rezultati i ndreqjes së njeriut**

Nëse ndreqet njeriu, është ndrequr çdo gjë.

➤ **Të këqijat që e shoqërojnë njeriun**

S'ka dyshim se njeriu asnjëherë nuk është i sigurtë prej të keqes së djallit dhe të keqes së vetes, deri në fund të jetës së tij.

➤ **Sprova dhe mirësia**

Ndoshta sprova është mirësi për njeriun dhe ndoshta mirësia mund të jetë provë për të.

➤ **Njeriu i përkryer**

Njeri i përkryer është ai i cili përpiqet të ndreqë çdo të keqe që kryen dhe nuk do t'ia dijë për pohimin e saj.

➤ **Burimi i lumturisë**

Kultura është burimi i lumturisë ose i trishtimit të ummetit (bashkësisë).



➤ **Kultura dhe vendi**

Nëse ndreqet kultura, ndreqet edhe vendi.

➤ **Rinia e përkryer**

Nëse kultura është në rregull, edhe të rinjtë tanë janë në rregull.

➤ **Kultura përcakton identitetin**

S'ka dyshim se kultura e çdo shoqërie përcakton identitetin dhe praninë e saj. Nëse kultura e një shoqërie do të ketë e devijuar, ajo shoqëri do të jetë e zbrazët, sado që mund të jetë e fuqishme në ekonomi, politikë, teknologji, etj.



➤ **Ne dhe qytetërimi**

Ne nuk jemi kundër qytetërimit. Por ne jemi kundër qytetërimit të importuar, sepse ai është shkaku i kësaj gjendjeje që jetojmë sot.

➤ **Pikënisja e reformimit të shoqërisë**

S'ka dyshim se rruga e reformimit të çdo shoqërie fillon me ndreqjen e kulturës së saj. Pra, duhet që reformimi të fillojë me ndreqjen e kulturës.

➤ **Ç'është historia?**

Historia është mësuesi i njeriut.

➤ **Roli i historisë**

Historia është pishtar ndriçues për brezat e ardhshëm.



➤ **Historianët dhe qëllimet e tyre**

Vërtet, nganjëherë historianët i therin qëllimet e revoltave në thertoren e qëllimeve të tyre apo për qëllimet e padronëve të tyre.

➤ **Roli i radios dhe televizionit**

Duhet që radioja dhe televizioni të jenë edukues për të rinjtë dhe të rejtat tona, po ashtu edukues edhe për popullin.



➤ **Kundër kujt jemi ne?**

Ne nuk jemi kundër radios, por ne jemi kundër shturjes morale; nuk jemi kundër televizionit, por jemi kundër çdo gjëje që i shërben të huajve për ta lënë rininë tonë në prapambetje. Ne jemi kundër çdo gjëje e cila çon në asgjësimin e fuqive tona njerëzore.


➤ **Kurdesi ndaj mjeteve të informacionit**

Duhet që radioja, televizioni, gazetat dhe revistat të luajnë rol udhëzues. Nuk duhet që gazetat dhe revistat të përhapin gjëra që e çojnë popullin në devijim.

➤ **Qëllimi i librave qiellorë**

S'ka dyshim se të gjithë librat qiellorë që u janë shpallur profetëve (a.s.) kanë patur si qëllim që njeriun (i cili nëse do të lihej i lirë do të ishte krijesa më e rrezikshme) ta vendosin nën hijen e një programi mësimor edukativ, me qëllim që të bëhet prej krijesave më të përsosura.





**Roli i gruas
në shoqëri**

➤ **Gruaja dhe shoqëria**

Vërtet, femra luan rol të madh në shoqëri. Ajo është frymëzuesja për të realizuar shpresat e njerëzve.

➤ **Roli i gruas**

Femra është edukatorja e njeriut.

➤ **Pikënisja e lartësimit**

Lartësimi i burrit e ka pikënisjen në kraharorin e femrës.

➤ **Gruaja, edukatorja e jetës**

S'ka dyshim se roli i gruas në shoqëri është më i rëndësishëm se roli i burrit, sepse femrat, duke qenë se janë pjesë aktive në të gjitha fushat e jetës, përballen me edukimin e pjesës tjetër aktive.



➤ **Përpjekjet e gruas në përhapjen e Islamit**

Ne jemi krenarë që femrat, të vogla e të mëdha, të reja e të moshuara, ushtrojnë rolin e tyre në fushën e kulturës, ekonomisë dhe ushtrisë njëlloj si meshkujt, apo në mënyrë më të përsosur, duke u përpjekur në përhapjen e Islamit dhe qëllimet e Kur'anit.



Fjalë të vyera / 62


➤ **Populli të cilin nuk e godasin dëmet**

S'ka dyshim se në atë popull ku gratë qëndrojnë krah për krah me burrat, për të realizuar qëllimet e Islamit, atë popull nuk e godet asnjë dëm (e keqe).

➤ **Burimi i ndreqjes dhe i shkatërrimit**

Reformini apo shkatërrimi i ndonjë shoqërie buron në ndreqjen a shkatërrimin e grave të asaj shoqërie.





**Të drejtat
e gruas**

➤ **Islami dhe gruaja**

Islami nuk është vetëm për lirinë e femrës. Ai është udhëheqës për çlirimin e gruas në të gjitha fushat e jetës së saj.

➤ **Të drejtat e gruas në Islam**

Në sistemin islam gruaja ka po ato të drejta njëloj si burri, si e drejta e studimit, e drejta e punës, e drejta e pronësisë, e drejta e konsultimit, e drejta për të zgjedhur (votimi), etj.

➤ **E drejta e gruas në jetë**

Në Islam nuk ka dallim mes gruas dhe burrit përsa i përket të drejtave njerëzore, sepse që të dy janë njerëz. Prandaj gruaja ka të drejtë të vendosë për jetën e saj njësoj si burri.



➤ Gruaja dhe ndërtimi i shoqërisë

Në sistemin islam edhe gruaja mund të marrë pjesë me burrat për ngritjen e shoqërisë islame.

➤ Gruaja nën hijen e Islamit

Vërtet, Islami e shpëtoi gruan nga ajo gjendje që ndodhej në epokën e *xhabilijetit* (inJORANCËS paraislamike). All-llahu e di më mirë se çfarë të mirash i ka dhënë Islami gruas, ndoshta këto mirësi janë më të shumta se sa ato të burrave.




➤ Përgjegjësia e gruas në ditët esotire

Duhet që në këto ditë, gratë të kryejnë përgjegjësinë e tyre shoqërore dhe fetare. Të mbrojnë nderin (moralin) e përgjithshëm dhe t'i kryejnë detyrat e tyre shoqërore e politike pa e njollosur këtë nder (moral).

➤ **Dita e gruas**

Nëse duhet që gratë të kenë një ditë të veçantë për to, a ka ditë më të madhe e më të nderuar se dita e lindjes së Hz. Fatimesë (a.s.)?





Pozita e nënës

➤ **Misioni më i ndershëm**

Nuk ka punë (mision) më të ndershme se sa ajo e nënës.

➤ **Shkolla e parë**

Shkolla e parë në të cilën hyn fëmija është kraharori i nënës.

➤ **Devijimi i fëmijës**

Nëse nëna devijon - një gjë të tillë mos e lejoftë All-llahu - edhe fëmija do të rritet i devijuar që në moshën fëmimore.

➤ **Ndreqja dhe ndërtimi i shoqërisë në dorën e nënës**

Vërtet, ndreqja e një shoqërie është në dorën tuaj, o nëna. Pra, shkatërrimi dhe ndërtimi i një vendi janë të lidhura me ju.





**Të rinjtë
dhe të rejat**

➤ **Këshillë për të rinjtë**

Unë u kërkoj të rinjve dhe të rejave që të mos reshtin së kërkuari liri, pavarësi dhe vlera të larta njerëzore, qoftë edhe nëse do të duhet të durojnë ndaj vështirësive (të përballen me to).

➤ **Rini dhe origjinaliteti i Islamit**

O të rinj! Duhet që ta merrni në konsideratë origjinalitetin e Islamit në kërkimet dhe në studimet e të vërtetave të tij në fushën e ekonomisë, shoqërisë, politikës, etj. Dhe mos e harroni dallimin mes Islamit dhe feve të tjera.



➤ **Triumfi i së vërtetës**

Të nderuar të rinj e të reja! Mos i hapni rrugë demoralizimit (pashpresës) për në vetet tuaja, sepse e vërteta është gjithmonë triumfuese.

➤ **Uniteti në thënie**

O të rinj e të reja! Është dëshirë dhe kënaqësi e imja që të sakrifikoni dhe të mbronit unitetin e thënieve tuaja (konsensusin tuaj).



➤ **Zbatimi i drejtësisë**

Zbatojeni drejtësinë! Mos kërkoni vetëm nga të tjerët që të bëjnë drejtësi, por tregoni drejtësi edhe ndaj vetëve tuaja!

➤ **Shkaku i devijimit**

S'ka dyshim se dalja prej ekuilibrit, prej drejtësisë së All-llahut dhe prej rrugës së drejtë, është devijim.

➤ **Edukimi i të rinjve**

Është domosdoshmëri që të rinjtë dhe të rejat, t'i edukojmë me edukatën e islamit.





**Namazi
dhe xhamitë**

➤ **Frikaedjallit**

Faleni namazin e Xhumasë në formën më të përkryer. Po ashtu edhe namazet e tjera, sepse djajtë i frikësohen namazit dhe xhamive.

➤ **Gjendja e falësit të namazit**

S'ka dyshim se All-llahut (xh.sh.) i pëlqen ta shohë robin e Tij të shkëputur (nga çështjet e kësaj bote), të përgjëruar dhe të sinqertë ndaj Tij, që nga koha e fillimit të namazit.

➤ **Xhamitë, vendet e edukimit**

Duhet që xhamitë, me plot kuptimin dhe me të gjitha dimensionet (e fjalës), të jenë vendet e mësimin e të edukimit...

➤ **Mbrojtja e xhamive**

Vërtet, mbrojtja e xhamive është prej çështjeve mbi të cilën mbështetet ekzistenca e Islamit.





Haxhi

➤ **Haxhi**

Haxhi është organizim dhe praktikë. Ai është *mejdan* dhe pasqyrë për vlerësimin e muslimanëve dhe të aftësive të tyre materiale e shpirtërore.

➤ **Kuptimi i politikës së Haxhit**

Nëse muslimanët do ta kuptojnë Haxhin dhe politikën që përmban ai, do të ishte e mjaftueshme për ata që të arrijnë pavarësinë e tyre.

➤ **Qëllimi i udhëtimit për në Haxh**

Kini kujdes! Udhëtimi për në Haxh nuk është udhëtim fitimi e tregëtie. Ai nuk është udhëtim për të fituar dynjanë, por ai është udhëtim për tek All-llahu (xh.sh.).





**Muaji
Muharrem**

➤ **Muaji i triumfit**

Muaji i Muharremit është muaji i revoltës së drejtësisë kundër padrejtësisë. Në këtë muaj u ballafaqua e vërteta me të pavërtetën. Ky muaj e vërtetoi se drejtësia është gjithmonë triumfuese mbi padrejtësinë gjatë gjithë historisë.

➤ **Ringjallja e mesazhit**

Përkujtojeni ndodhinë e Kerbelasë dhe përkujtojeni emrin e bekuar të zotërisë së dëshmorëve (Imam Husejnin a.s.), sepse përkujtimi i tyre është ringjallje për Islamin.

➤ **Dita e dhjetë e Muharremit, ditë zie**

Ashura (dita e dhjetë e muajit Muharrem) është ditë zie për popullin e shtypur, ajo është



dita e masakrës dhe dita në të cilën lindi për së dyti Islami dhe muslimanët.

➤ **Martirizimi është krenari**

Martirizimin në rrugën e së vërtetës dhe në rrugën e qëllimeve hyjnore, unë e quaj krenari të përhershme.


➤ **Dbitetë e durimit**

Durimi është çelësi i portave të lumturisë dhe baza e shpëtimit prej shkatërrimeve.



➤ **Dbita e martirizimit**

Martirizimi i zotërisë së dëshmorëve e ringjall mesazhin.



Porosi e këshilla

Së pari: Unë porosis të gjithë të rinjtë e të rejtat, baballarët, nënat dhe të dashurit e tyre, e më pas personalitetet dhe drejtuesit e shtetit, të cilët interesohen për ruajtjen e interesave të vendit. I porosis të gjithë ata që të përpiqen ta ruajnë vendin e tyre si dhe amanetin e ruajtjes së universiteteve për brezat e ardhshëm.

Unë këshilloj të gjithë popujt muslimanë, që të mos presin t'i ndihmojë askush nga jashtë për realizimin e qëllimeve të tyre në zbatimin e rregullave të Islamit. Por ata vetë të ngrihen për realizimin e qëllimeve të tyre, të cilat u sigurojnë atyre lirinë dhe pavarësinë.



Porosia ime për shkrimtarët, oratorët e mendimtarët të cilët nxisin konflikte e mosmarrëveshje dhe që nuk besojnë në Zot, që të qëndrojnë një pjesë kohe e ta mëtojnë

Zotin ose të meditojnë në vetmi. Kjo do të ishte më mirë se sa ta shpërdoronin kohën e tyre duke kundërshtuar dhe duke nxitur konflikte...

I porosis të gjithë, që të përpiqen për ngritjen e mirëqenies së shtresës së varfër. Sepse, interesimi për çështjen e kësaj shtrese përmban mirësi në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Sa mirë është që shtresa e pasur e shoqërisë të jetë vullnetare për ndryshimin e mirëqenies së shtresës së varfër me të gjitha mënyrat. Ata (të pasurit) të jenë të bindur se në këtë veprim të tyre ka mirësi si për këtë jetë ashtu edhe për jetën tjetër...





Imam Homeini

➤ **Emri më i pëlqyer**

Të më thërrasin *shërbyes* është më mirë se sa të më thonë *udhëheqës*, sepse udhëheqja nuk është e rëndësishme. I rëndësishëm është shërbimi, sepse Islami na urdhëron për shërbim.

➤ **Udhëheqja apo vëllazëria?**

Në Islam - sipas mendimit tim - nuk është e rëndësishme çështja e udhëheqjes, por vëllazëria është më e rëndësishme.

➤ **Të gjithë jemi një**

Vërtet, Homeini jua puth juve duart një nga një dhe ju respekton të gjithëve dhe çdonjërin prej jush e konsideron udhëheqës të tij. Unë



e kam përsëritur disa herë që ju dhe unë jemi një.

➤ **Puthja e duarve**

Unë u puth duart dhe llërët të gjithë atyre të dashurve të zemrës time, të cilët mbajtën mbi supet e tyre përgjegjësinë e triumfit dhe ishin të vendosur e të palëkundur në rrugën e Allahut dhe në lartësimin e krenarisë së muslimanëve. Unë i përshëndes me çiltërsi të gjithë fatosat e lirisë e të përsosurisë.





**Mesazhi
i Imam Homeinit
drejtuar Gorbaçovit**

Vijon teksti integral i mesazhit të IMAM HOMEINIT drejtuar liderit sovjetik, Gorbaçovit, i cili është botuar më 8 janar të vitit 1989:

**Në emër të All-llahut,
Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

Shkëlqesia Juaj, zotëri Gorbaçov, kryetar i Presidiumit të Sovjetit Suprem të BRSS-së. Ju dëshiroj sukses dhe fat Juve dhe popullit sovjetik.

Duke patur parasysh se ardhja Juaj në pushtet ka nxitur ndjenjën se Shkëlqesia Juaj është i gatshëm ta ndërrojë dhe transformojë politikën botërore, posaçërisht kur është në pyetje Bashkimi Sovjetik dhe trimëria e guximi juaj në ballafaqim me situatën reale në botë, do të mundet (shumë mirë) të jetë



burim i transformimit dhe shkak i ndryshimeve në kushtet e tashme botërore, konsideroj se është e domosdoshme t'i përmend disa çështje.

Madje edhe pse fusha e ideve dhe vendimeve Tuaja të reja do të mund të konsiderohej vetëm metodë e thjeshtë për zgjidhjen e problemeve partiake, kurse paralelisht me këtë do të duhej të zgjidhë edhe disa nga problemet e popullit Tuaj, madje edhe në këtë përmasë, guximi që të ndërroni doktrinën e cila për një kohë të gjatë i ka kufizuar fëmijët revolucionarë të botës dhe i ka mbajtur pas perdes së hekurt, meriton lëvdatë. Nëse mund ta kuptoni, ajo që gjithsesi dhe në rend të parë do t'ju sjellë sukses, është ndërrimi i politikës së pararendësve Tuaj, sepse është e mbështetur në largimin nga Zoti dhe feja, që gjithsesi i ka dhënë goditjen më të rëndë dhe më të madhe popullit të Bashkimit Sovjetik. Dhe do të duhej



të jeni të vetëdijsëm se qasja reale kah situata botërore është e pamundur pa këtë.

Gjithsesi, është e mundur që për shkak të metodave jo të përshtatshme dhe paraqitjes së gabuar të ish-personaliteteve komuniste, të cilat kanë patur ndikim të fuqishëm në sferën e ekonomisë, do të tregohet se çka ka bërë tërheqshmëria e Perëndimit. Mirëpo, gjendja e vërtetë e çështjeve qëndron në diçka tjetër. Nëse tashmë do të përpiqeni që të zgjidhni nyjet ekonomike të Gordit në socializëm dhe komunizëm, me anë të kërkimit strehim në qendrën e kapitalizmit perëndimor, jo vetëm që nuk do t'i shëronit sëmundjet e shoqërisë suaj, por do ta bënit situatën të atillë që të tjerët më vonë do t'u duhet t'i përmirësojnë gabimet tuaja. Sepse, nëse marksizmi dhe metodat ekonomike e shoqërore (të udhëhequra në mënyrën marksiste), sot kanë rënë në qorrsovak, bota perëndimore



gjithashtu është ngatërruar në gjërat e njëjta, natyrisht, por në mënyrë tjetër dhe për shkak të problemeve të tjera.

Shkëlqesia Juaj Gorbaçov! Duhet kthyer drejt së vërtetës. Problemi më i madh i vendit Tuaj nuk është ai i pronësisë, ekonomisë dhe lirisë. Është pikërisht mungesa e besimit të vërtetë në Zot, ai problem i cili e ka shpjerë ose do ta shpjerë Perëndimin në vulgarizëm dhe qorrsohak. Problemi Juaj kryesor është lufta e gjatë dhe e shterpë kundër Zotit, i Cili është burim i të ekzistuarit dhe i krijimit.

Shkëlqesia Juaj Gorbaçov! Të gjithë e kanë të qartë se në të ardhmen, komunizmi do të duhet të kërkohet në muzeumet politiko-historike të botës, sepse marksizmi nuk ofron zgjidhje për asnjë nevojë reale të njeriut. E gjithë kjo, sepse ai është një doktrinë materialiste dhe se materializmi nuk mundet



që njeriun ta nxjerrë nga krizat e mungesës së besimit në çështjet shpirtërore, çka është edhe vuajtja më e madhe e shoqërisë njerëzore, si në Perëndim ashtu edhe në Lindje.

Shkëlqesia Juaj Gorbaçov! Ju, mbase krejtësisht në disa aspekte, nuk ia keni kthyer shpinën marksizmit dhe mbase edhe më tej - në vazhdim - do të vazhdoni të deklaroni se besoni në të. Por Ju personalisht e dini me bindje se ai nuk është ashtu (siç duket). Lideri kinez ia dha goditjen e parë komunizmit. Kurse ju ia keni dhënë të dytën - si duket - vendimtarë. Sot në botë nuk kemi asgjë që do të mund të quhej komunizëm. Do t'ju lutesha në mënyrë emfatike që të mos lejoni t'ju robërojë Perëndimi dhe *djalli më i madh* në shkatërrimin e mureve të iluzioneve marksiste. Shpresoj se do të keni nderin që t'i mënjaroni edhe shtresat e fundit dekadente të lajthitjes 70-vjeçare të komunizmit botëror nga



sipërfaqja e tokës dhe historisë Suaj. Sot, ato pushtete të cilat e ndjekin drejtimin e njëjtë sikurse edhe Ju - zemrat e të cilëve rrahin për atdhetë dhe popujt e tyre - nuk janë më të gatshme që të përdorin burimet nëntokësore dhe sipërfaqësore për të dëshmuar suksesin e komunizmit, për shpartallimin e të cilit kanë dëgjuar madje edhe fëmijët e tyre.

Zotëri Gorbaçov! Kur nga minaret e xhamive në disa nga republikat tuaja, dëgjohej thirrja: “All-llahu është më i Madhi” (All-llahu Ekber) dhe pohimi i pejgamberisë së të Dërguarit të Fundit (selami i All-llahut qoftë mbi të), lotët e gëzimit shkëlqyen në sytë e të gjithë atyre të cilët e përkrahin Islamin e pastër Muhammedan.

Së këndejmi, konsideroj se është e domosdoshme t’Ju kujtoj që edhe njëherë ta shqyrtoni botëkuptimin materialist dhe teist (fetar) mbi botën. Në botëkuptimet e tyre mbi



botën, materialistët janë të mendimit se shqisat janë kriter i njohjes dhe dijes, duke konsideruar se e tërë ajo që është e paprekshme, është jashtë fushës së shkencës. Sipas tyre, ekzistenca është e barabartë me materien dhe se çdo gjë që është jomaterie, në të vërtetë nuk ekziston. Pashmangshmërisht, atë që ata e konsiderojnë si botë të paprekshme - si ekzistenca e Zotit të Lartësuar, shpallja, pejgamberia dhe ringjallja - është trillim. Ndërsa pikëpamja teiste (fetare) mbi botën, nënkupton që si shqisat, ashtu edhe arsyeja janë kriter të njohjes dhe dijes. Çdo gjë që është racionale, është në suaza të fushës së shkencës edhe pse është e paprekur. Prandaj, ekzistenca e të dy aspekteve, aspektit subjektiv dhe atij objektiv, si dhe çdo gjë që është jomateriale, mund të ekzistojë. Ashtu sikurse materia varet nga mendja, po ashtu edhe perceptimi shqisor varet nga dija subjective.



Nuk kam pasur për qëllim që t'ju lodh me gjarpërimet filozofike, veçanërisht me ato islame. Është e mjaftueshme nëse përmend një apo dy shembuj, të cilët do të ishin të dobishëm edhe për politikanët.

Është evidente se materia dhe gjëja - çfarëdo të jetë ajo - nuk është e vetëdijshme për vetveten. Ne qartë mund të shohim se njerëzit dhe kafshët janë të vetëdijshëm për gjithçka i rrethon. Ata dinë ku gjenden dhe ç'ndodh përreth tyre. Prandaj, ekziston diçka te njerëzit dhe kafshët që është mbi materien, është e ndarë nga bota e materies dhe që s'vdes pas zhdukjes së materials.

Nga natyra, njerëzit synojnë drejt të gjitha llojet e lartësimeve (përsosurive) me krejt kuptimin e fjalës dhe jeni të vetëdijshëm se njeriu dëshiron të jetë fuqia absolute e botës. Për këtë shkak, duhet medoemos të ekzistojë



edhe pushteti absolute, edhe dija absolute. E, ky është Zoti i Madhëruar.

Nëse Shkëlqesia Juaj dëshiron t'i hulumtojë këto fusha, mund t'i orientoni hulumtuesit që t'u referohen veprave të Farabiut dhe Ebu Ali Sinaït (Ibn Sina, Avicena) në Ma'ash filozofinë, që të bëhet e qartë se ligji i shkaqeve dhe pasojave, mbi të cilat mbështeten të gjitha dituritë, është logjik e jo subjektiv. Gjithashtu, edhe të kuptuarit e domethënies themelore edhe të ligjeve të përgjithshme, në të cilën mbështet arsyeja e tërësishme, po ashtu është logjike e jo subjektive.



Gjithashtu, mund t'u referohen edhe veprave të Suhraverdit mbi filozofinë iluministe (*felsefetul ishrak*), e cila do t'ju sqarojë se materies dhe çdo gjëje tjetër materiale, i nevojitet drita e zemrës së ndjeshme. Edhe dija e njeriut mbi të vërtetën e tij, gjithashtu është pa fenomenin *ndijim*. Thuajuni

intelektualëve tuaj që t'i referohen filozofisë së lartë të Sadrullah Montealehinit, që të bëhet e qartë se e vërteta e shkencës është e ndarë nga materia dhe nuk i nënshtrohet rregullave të cilat zotërojnë me materien.

Nuk i kam përmendur veprat e dijetarëve islamë. Nëse Ju interesojnë qëndrimet e Muhjiddin Arabiut, mund të na i dërgoni disa ekspertë tuajt të vijnë në Kom, që pas disa vitesh – duke u mbështetur në Zotin – ta mësojnë thellësinë e dijes.

Shkëlqesia Juaj Gorbaçov! Do t'Ju lutesha të filloni seriozisht ta hulumtoni Islamin, jo për arsye se i nevojiteni Islamit dhe muslimanëve, por për shkak të vlerave të larta dhe universale të Islamit, të cilat mund të jenë burim i ngushëllimit dhe shpëtimit të të gjithë popujve në zgjidhjen e problemeve themelore të njerëzisë.



Një vështrim serioz në Islam, përgjithmonë mund t'ju shpëtojë nga problemi afgan dhe të tjera (probleme) të ngjashme. Muslimanët e botës janë të njëjtë sikur edhe muslimanët në vendin tonë. Fati i tyre është edhe fati ynë. Me lirinë relative të ceremonive fetare në disa republika sovjetike, keni treguar se nuk mendoni që religjioni (feja) është opium.

Po, ai religjion i cili pasurinë materiale edhe shpirtërore të vendeve islame dhe joislame, e vë në dispozicion të superfuqive dhe “fuqive” të tjera dhe i cili zëshëm ia përsërit popullit se religjioni është i ndarë nga politika, ai religjion është opium për shoqërinë. Por ky nuk është religjion i mirëfilltë. Religjionin e këtillë populli e quan “religjion amerikan”.

Në përmbyllje, do të dëshiroja që në mënyrë të qartë, të deklaroj se Republika Islame e Iranit, si baza më e madhe dhe më e fuqishme e botës islame, mund ta kompensojë



me lehtësi mungesën e fesë në sistemin tuaj. Sidoqoftë, vendi ynë – sikurse deri tani – beson në marrëdhënie të mira fqinjësie dhe dypalëshe dhe i respekton ato.

Përktheu: Nexhat Ibrahimi



Përmbajtja

<i>Në vend të parathënies.....</i>	<i>5</i>
<i>Detaje nga jeta e Imam Homeinit.....</i>	<i>10</i>
<i>Njohja e All-llahut dhe adhurimi i Tij.....</i>	<i>15</i>
<i>Të dërguarit e All-llahut.....</i>	<i>22</i>
<i>Feja islame.....</i>	<i>25</i>
<i>Mbrojtja e Islamit.....</i>	<i>31</i>
<i>Kur'ani.....</i>	<i>36</i>
<i>Ringjallja dhe gjykimi.....</i>	<i>40</i>
<i>Përpyjekjet reformuese.....</i>	<i>43</i>
<i>Roli i gruas në shoqëri.....</i>	<i>60</i>
<i>Të drejtat e gruas.....</i>	<i>64</i>
<i>Pozita e nënës.....</i>	<i>68</i>
<i>Të rinjtë dhe të rejat.....</i>	<i>70</i>
<i>Namazi dhe xhamitë.....</i>	<i>74</i>
<i>Haxhi</i>	<i>76</i>
<i>Muaji Mubarrem.....</i>	<i>78</i>
<i>Porosi e këshilla.....</i>	<i>81</i>
<i>Imam Homeini.....</i>	<i>84</i>
<i>Mesazhi i Imam Homeinit drejtuar Gorbaçovit.....</i>	<i>87</i>